

Lufta për parandalimin e pastrimit të parave në ndryshimet ligjore të propozuara gjatë ditës së sotme, përfshirë edhe dy ligjet për të cilat po diskutojmë aktualisht, ndryshimet e propozuara në ligjin “Për noterin” dhe ligjin e ri “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme”, pra me këtë paketë ligjesh, lufta futet në një fazë të re, në një fazë të thellimit të saj dhe kjo, padyshim, do të kërkonte, në fakt, mbështetjen e të gjithëve në këtë Kuvend, sepse përgjegjësia jonë në fund të ditës nuk është as të bëjmë gjyqtarin, as të bëjmë prokurorin, por të respektojmë atë për të cilën jemi zgjedhur, të jemi deputetë dhe, për rrjedhojë, të ofrojmë legjislacion dhe të sigurohemi që në legjislacion ne fusim standardin më të mirë bashkëkohor. Fatkeqësisht, retorika politike është bërë kaq e dendur, kaq e gjatë, kaq e lodhshme, saqë, në fakt, nuk i lë vend dëgjimit të arsyes, nuk i lë vend dëgjimit me kujdes dhe deri në fund justifikimit publik pse po bëhet ky ndryshim, pse duhet ky ndryshim dhe e gjitha shkon deri aty saqë, me dashje, vihen në dyshim edhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë. MONEYVAL-i dhe FATF-ja janë trupa monitoruese të Këshillit të Europës dhe, sigurisht, janë të njohur dhe prestigjiozë për ekspertizën që ato ofrojnë. Ne jemi parlamentarë dhe le t’i përgjigjemi kësaj përgjegjësie, që, në fakt, nuk është e vogël, është pa dyshim një përgjegjësi e madhe dhe një përgjegjësi e lartë.

Ndryshimet në ligjin “Për noterët” apo “vetingu i noterëve”, siç dikush parapëlqen ta quajë, i referohen thjesht dhe vetëm një mekanizmi të thjeshtë dhe, në fakt, të shumëpërdorur, që siguron integritetin dhe besimin tek të gjithë ata që ofrojnë një shërbim publik, siç është ai i noterisë. Është një shërbim kyç, në fakt, sepse çdo transaksion finalizohet dhe merr vlerë përfundimtare pikërisht te noterët, edhe ato transaksione nëpërmjet të cilave paraja e pistë synon të hyjë në ekonominë e ligjshme. Është krejt e qartë. Noterët janë pikë fokale. Ata kanë aksesin në të dhënat e çdo pasurie. Kanë formimin, në mos presupozohet që kanë formimin për të kuptuar dhe investiguar origjinën e çdo prone, kanë formimin për të siguruar vlefshmërinë e çdo titulli e, për rrjedhojë, bashkëpunimi i tyre, reagimi i tyre është shumë i çmuar, sikundër edhe për logjikë, rezulton e domosdoshme që në këtë lloj shërbimi dhe sipas këtyre kërkesave që përmendëm, nuk mund të përfshihen individë me rekorde të rënda me krimin apo që kanë lidhje të qartë me persona të dënuar. Ndryshimet nuk kanë efekt prapaveprues, në kuptimin që verifikimet në drejtim të integritetit dhe të besueshmërisë do të bëhen për të gjithë ata që kandidojnë për noter, ndërkohë që pretendimi i këtyre ndryshimeve të sjella në këtë ligj dhe premtimi i këtij ligji është që do të forcohet inspektimi ndaj noterëve, në mënyrë që e gjithë kjo veprimtari të sigurohet brenda kornizës së duhur ligjore. (Ndërhyrje pa mikrofon) Është gjëja e duhur apo jo? Për ne në Komisionin e Ligjeve, por besoj për shumicën në të gjitha komisionet parlamentare, ku ky projekt është diskutuar, ishte kështu, por nuk ishte kështu për Partinë Demokratike.

Dhe unë këtu, në fakt, detyrohem t’ju përfshij të gjithëve bashkë, pavarësisht se disave u pëlqen ta identifikojnë veten këtu apo aty, sipas konvencencës. Megjithatë, në gjykimin tonë, jeni dhe do të mbeteni i njëjti stof. Partia Demokratike votoi kundër këtyre ndryshimeve dhe këtë qytetarët duhet ta dinë, sepse kjo votë nuk ishte kundër ligjit, në fakt, në vetvete, por është një votë e cila mbron kastën e të gjithë atyre noterëve që janë licencuar për vite e vite me radhë si qokë në shërbimin noterial. Dhe në këtë rast më lind e drejta ta them me gojën plot që, duke votuar kështu dhe duke mbajtur këtë qëndrim, as më shumë dhe as më pak, u keni bërë një shërbim të gjithë atyre që përpiqen ta rrenojnë ekonominë e ligjshme, u keni bërë një shërbim të gjithë atyre që ndërhyjnë në ekonomi për të pastruar paratë e pista, ato para që në shumicë vijnë nga veprimtaria kriminale. I keni rënë në

këtë mënyrë çdo biznesi të vogël, çdo biznesi të madh, çdo biznesi të ndershëm, atij që, në sajë të fuqisë së mendjes dhe fuqisë së ekonomisë, sigurisht që na nderon. Ne nuk jemi në këtë anë, sepse as tani dhe as kurrë, jua kemi thënë dhe jua konfirmojmë, madje ka prova të qarta për këtë, se nuk i japim mbrojtje asnjë shkelësi. Ligji “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme” është propozim i të njëjtit nivel, i të njëjtit qëllim, i së njëjtës rëndësi, por diskutimet e të gjithë deputetëve të Partisë Demokratike, pra, të gjithë bashkë kërkuan që t’i banalizonin këto ndryshime, madje shkuan deri aty sa i etiketuan si ndryshime të qëllimshme, që synojnë ndërhyrjen në një treg të lirë. Imagjinoni, treg i lirë, treg i pakufizuar, kur jo më larg se në një vend fqinj si Italia, që është ekonomia e katërt ose e pestë e botës, ky treg i ndërmjetësve apo i atyre që njihen si “agjentët imobiliarë”, rregullohet që prej vitit 1989 dhe në vijim dhe i nënshtrohet një kuadri ligjor shumë të rreptë, u nënshtrohet një sërë detyrimeve që i takojnë jo vetëm njohjes së atyre që janë agjentë imobiliarë, por edhe garancisë që këta njerëz të mos jenë mashtrues të ligjit, të mos jenë ata që krimi i fut në veprim për të kontabilizuar në dokumente, që pastaj i drejtohen shtetit, pasuri të prejardhura nga veprimtaria kriminale. Të qenit ndërmjetës i pasurive të paluajtshme konsiderohet vërtet profesion i lirë, ama veprimtaria që ata ushtrojnë nuk duhet të jetë kaq e lirë, saqë kjo veprimtari, që i paraprin, në fakt, asaj të noterëve, që zhvillohet mu në zemër të një veprimtarie shumë të gjerë të shitjes dhe të blerjes, të dhënies me qira të pronave të paluajtshme, imagjinoni që shiten e blihen edhe biznese, të mos i nënshtrohet asnjë rregullimi.

Që prej vitit 1989 dhe deri në vitin 2011 shteti italian vazhdon dhe bën legjislacion për këtë pjesë, ndërsa ne për herë të parë bëjmë një ligj për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme sot në vitin 2022. Normal, na është rekomanduar me të drejtë nga ekspertiza e Bashkimit Europian në fushë, është bërë realitet, e dimë të gjithë. Statistika që u dha, në fakt, në disa komisione, që ky lloj tregu zë 8% deri në 9% të transaksioneve lidhur me pasuritë e paluajtshme, patjetër që është një statistikë apo një analizë e përciptë, sepse në fund të ditës jemi qytetarë dhe ne e shohim, e prekim që edhe për nevojën më të thjeshtë, qoftë edhe për nevojën e një qiramarrjeje, njerëzit i drejtohen pikërisht këtij tregu, tregut të imobiliareve, që lidhen dhe qëndrojnë jo thjesht me blerësit dhe shitësit, por ato lidhen edhe me noterët, edhe me bankat. Ju dëgjoj shpesh të citoni me një lloj vetëmburrjeje, a thua se e keni thënë ju të parët këtë shprehje: “Të gjejmë paratë. Të gjurmojmë paratë që të gjejmë krimin”. Po, mor, po, kështu është! E pra, paratë, çdo pronë e paluajtshme, që në vetvete nënkupton vlerë, nënkupton para, të dhënat e origjinës së saj dhe të titullarëve të saj lëvizin tanimë, është e sigurt që çdo ditë e më shumë do të lëvizin dhe lëvizin edhe në duart e këtyre njerëzve, agjentëve imobiliarë, madje lëvizin edhe në ekranin virtual, sepse çdo gjë nuk ndodh vetëm praktikisht, nuk ndodh vetëm fizikisht, por ndodh edhe online, që u ofrohet qoftë blerësve, qoftë shitësve. Tani, a nuk është detyrë e shtetit, a nuk është detyrë e institucioneve që ne të kemi një sy në këtë treg dhe të mos lejojmë që mashtruesit, ordinerët, trafikantët, çfarë të doni ju, financuesit e terrorizmit, të hyjnë në këtë treg dhe në këtë zinxhir kaq të rëndësishëm të ekonomisë, që nis me blerësin dhe përfundon me shitësin? A nuk ka për detyrë shteti t’i sigurojë të gjithë qytetarët që këta ndërmjetës, që në shumicë nuk janë vetëm persona fizikë, janë të organizuar në zyra, të kenë njohuri qoftë edhe minimale të ligjit, të ekonomisë, të kenë njohuri të tatimeve?

Pra, në fund të ditës, të kenë detyrimin si çdo qytetar në këtë vend që të kallëzojnë diçka që është e paligjshme dhe të mos e fshehin dhe të mos e mbulojnë atë që është e tillë. Unë nuk besoj që dikush do të thoshte: “Jo, këta bëjnë përjashtim”, në emër të veprimtarisë së lirë. Kush e ka për detyrë ta luftojë pastrimin e parave të pista? E ka shteti, e kemi ne, dhe arroganca me ngjyrë partie që shfaqet edhe ajo shumë rëndom, nuk duhet të jetë një arsye për të mos u bërë pjesë aktive e kësaj lufte! Unë nga këtu dua që të gjithë qytetarët, në fakt, ta dëgjojnë dhe ta kuptojnë se ka një grup deputetësh që janë arrivistë, në fakt, politikë, të cilët të gjithë retorikën e bëjnë vetëm për karrierë, kryesojnë fjalomaninë para çdo mikrofoni që u vihet përpara, ndërkohë që ne kemi punë për të bërë dhe kemi

mundësinë për ta çuar vendin përpara pikërisht përmes miratimit të atyre iniciativave që ia vlen t'i miratosh. Dhe kjo është një nga ato iniciativa ligjore, së bashku me ligjin tjetër, atë "Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme" që ia vlejné të votohen pro dhe ke arsye pse ta mbash kokën lart. Faleminderit!